



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI JURIDIK
PRISHTINË

Pranuar me: 30.09.2024			
Ni. org.	Numër	Sasia	Vlera
10/79			

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI JURIDIK
Katedra e së Drejtës Ndërkombëtare

Për: Rektorin e Universitetit të Prishtinës, Prof. Dr. Arben Hajrullahu
Kryesues i Senatit të Universitetit të Prishtinës

Kopje: Këshillin e Fakultetit Juridik

Nga: Prof. Ass. Dr. Donikë Qerimi, Shefe e Katedrës Ndërkombëtare
Ass. Mr.sc. Valëza Ukaj, Sekretare e Katedrës Ndërkombëtare

Datë: 30 shtator 2024

Lënda: Parashtresë

Katedra e së drejtës ndërkombëtare, në mbledhjen e mbajtur me datë 30 shtator, me pjesëmarrje fizike të: Prof. Dr. Iliriana Islami, Prof. Dr. Asoc. Remzije Istrefi, Prof. Dr. Asoc. Flamur Mrasori, Prof. Ass. Dr. Bekim Sejdiu, Prof. Dr. Ass. Donikë Qerimi, Assist. Vigan Qorrolli dhe Assist. Valëza Ukaj, si dhe me mbështetjen e pazezervë të dhënë në mënyrë elektronike nga Rektori Prof. Dr. Qerim Qerimi, Prof. Dr. Hajredin Kuçi, Prof.dr. Asoc. Besfort Rrecaj, janë dakorduar për këtë parashtresë me qëllim sqarimi për Rektorin dhe Senatin e Universitetit të Prishtinës:

Katedra e së drejtës ndërkombëtare shpreh protestën, kundërshtimin dhe shqetësimin e thellë në lidhje me vendimin e Këshillit të Etikës 2/906 të datës 27.09.2024 me të cilin janë rekomanduar një sërë masash degraduese për anëtarin e Katedrës sonë, Prof. Dr. Enver Hasani.

Është qëndrim i kësaj katedre se rekomandimet e Këshillit të Etikës duhen refuzuar nga Senati i Universitetit si rekomandime juridikisht të pabazuara, jo proporcionale dhe thellësisht johumane. Katedra e së drejtës ndërkombëtare dëshiron të qartësojë për Rektorin, Senatin e Universitetit të Prishtinës, për studentët dhe për publikun e gjerë, se Prof. Dr. Enver Hasani nuk ka shpërfillur apo "*mospërmbushur qëllimshëm*" detyrimet e tij të mësimdhënies të caktuara me ligj dhe kontratë.

Më 20 prill 2023, anëtarët e Katedrës sonë janë informuar nga Prof. Dr. Hasani se ai kishte marrë diagnozën e parë me sëmundjen e rëndë të leukemisë dhe se pritej që ajo të konfirmohej edhe jashtë vendit dhe potencialisht të fillojë trajtimin për këtë sëmundje brenda dhe jashtë Kosovës. Lajmi i rëndë për gjendjen serioze të anëtarit më senior të katedrës ka qenë tronditës për të gjithë dhe, natyrshëm, ka mobilizuar të gjithë për të ndihmuar në këtë situatë. Në

mbledhjen e radhës së katedrës, është diskutuar për nevojën e kolegëve për t'u angazhuar në mbulimin e orëve të ligjeratave të Prof. Hasanit.

Qëndrimi i përbashkët i katedrës, i marrë më datën 2 tetor 2023, për të mbuluar orët e Prof. Hasanit është marrë duke pasur parasysh se natyra malinje e sëmundjes së rëndë dhe trajtimet *është krejtësisht e paparshikueshme*. Prandaj as për Profesorin e as për anëtarët e katedrës nuk ka mundur të dihet se për sa kohë do të kërkohej zëvendësimi i kolegut – për ndonjë javë apo për më tepër. Me kalimin e kohës, rëndimit të gjendjes shëndetësore të Prof. Hasanit për shkak të terapisë, anëtarët e katedrës sonë kanë vazhduar të konfirmojnë gadishmërinë për të mbuluar orët si njëri nga minimumet e mundshme të sjelljes humane dhe kolegiale në një situatë të këtillë.

Është thellësisht shqetësuese për ne se sëmundja vdekjepruese e leukemisë, trajtimet me kemoterapi dhe të tjera, nuk përbëkan “rast tejet përjashtimor dhe atë për shkaqe dhe arsye legjitime, të cilat arsyetime duhen të jenë bindëse”, sic ka theksuar vendimi i KE-së (fq. 8).

E dyta, jo më pak e rëndësishme, KE nuk ka marrë për bazë faktin se për këtë mungesë Prof. Hasani ka pasur edhe lejen e Rektorit të atëhershëm të Universitetit, Prof. Qerim Qerimi, anëtar i katedrës sonë. Në diskutimin e përbashkët elektronik të katedrës, të bërë më 20 prill 2023, Rektori i atëherëshëm, përveç që kishte shprehur keqardhjen dhe mbështetjen për Prof. Hasanin, ka thënë (shkruar) se nuk është e nevojshme që të ndiqen formalitetet tjera me dokumentim të situatës dhe kërkimit të lejeve, duke e konsideruar të mjaftueshëm juridikisht këtë komunikim elektronik të katedrës si më sipër.

Duke marrë për bazë lejen e Rektorit, bashkë me paparashikueshmërinë e sëmundjes dhe kapacitetet e katedrës për t'i siguruar mbarëvajtjen e mësimi, kolegët e katedrës me humanitet të plotë dhe kolegialitet kanë vazhduar të mbulojnë orët në interesin më të mirë të studentëve. Gjatë gjithë kohës sa është kryer zëvendësimi, as Prof. Hasani e as kolegët e katedrës nuk kanë pasur as indikacionin më të vogël për ndonjë pakënaqësi të menaxhmentit në lidhje me këtë zëvendësim, ndonjë vërejtje apo veprim juridik. Po të ekzistonte një vërejtje e çfarëdoshme, katedra në bashkëpunim me Profesorin do të procedonin kërkesat formale për leje, të arsyetuar mirë me dokumentacionin e nevojshëm mjekësor.

E treta, është e papranueshme dhe faktikisht i pabazuar konstatimi i KE-së se menaxhmenti ka qenë i painformuar për këtë situatë. Katedra rithekson se mbulimi i orëve të Prof. Hasanit asnjëherë nuk është mbajtur fshehurazi nga menaxhmenti, e as nuk ka mundur të mbahet i fshehur nga menaxhmenti. Kjo meqë natyra e detyrimeve është e tillë duke qenë se ligjeratat janë publike dhe dihet lehtësisht se si mbahen ato. Është esenciale të ceket se të gjitha listat e dorëzuara në adresën e caktuar kanë pasur qartazi nënshkrimin e kolegëve të tjerë dhe mbishkrimin “për Prof. Enver Hasani”. Edhe sikur të mos kishin informata tjera, vetë listat e dorëzuara – të cilat mëtohen të jenë vlerësuar nga menaxhmenti dhe KE – mjaftojnë për të dëshmuar dijeninë e vazhdueshme të menaxhmentit.

Për më tepër, sëmundja dhe trajtimi i Prof. Hasanit janë Kosovës kanë qenë të ditura edhe për publikun. Prandaj, konstatimi i KE-së, në disa pika të vendimit, se për këtë nuk ka pasur dijeni as zyrtari për mësim e as Dekani është jo vetëm i pabazë por edhe absurd. Përtej kësaj, është

po kaq shqetësuese se si KE lehtësisht arrin në konkluzionin se si menaxhmenti nuk ka ditur për mungesën e Profesorit dhe zëvendësim e orëve nga stafi tjetër akademik, por as shkarazi nuk diskuton përgjegjësinë juridike të menaxhmentit për kontrollin e mirëmbajtjen e procesit mësimor nga ata dhe mospërmbylljen eventuale të kësaj përgjegjësie nëse me të vërtetë paskan qenë të painformuar për një zhvillim të këtillë.

Për fund, duhet cekur se nuk janë përmbushur kriteret ligjore për t'u zbatuar masat e rekomanduara nga KE. Si pikë e parë, neni 6.1.13 i Rregullores për masat disiplinore ndaj personelit kërkon që për t'u aplikuar masat në lidhje me mospërmbyllje të detyrimeve, ajo mospërmbyllje duhet të jetë bërë *qëllimshëm*. Të gjitha elementet e cekura më sipër, duke u nisur nga natyra e sëmundjes dhe trajtimit, paparashikueshmërisë së kohëzgjatjes së tyre, leja dhe dijenia e menaxhmentit në lidhje me mungesat, e bëjnë krejtësisht të qartë se një mospërmbyllje e qëllimshme as nuk ka ndodhur e as nuk ka mundur të ndodhë.

Si pikë e dytë në këtë drejtim, duhet theksuar se shqiptimi i masave disiplinore, veçanërisht këtyre të rënda që janë rekomanduar nga KE, shqiptohet për shkeljet e rënda të Kodit të Etikës, vetëm pasi të jenë jenë konsumuar masa e procedura të tjera paraprake juridike.

Për këto arsye, Katedra e së drejtës ndërkombëtare kërkon nga Senati i Universitetit që të refuzojë rekomandimet e Këshillit të Etikës si juridikisht të pabazuara, të paarsyeshme dhe thellësisht johumane.

Me respekt,

Prof. Ass. Dr. Donikë Qerimi



Shefe e Katedrës Ndërkombëtare

Ass. Mr. Sc. Valëza Ukaj



Sekretare e Katedrës Ndërkombëtare